

KONVENTA E RAMSARIT

- Konventa për Ligatinat është marrëveshje ndërkombëtare që trajton ruajtjen e ligatinave të rëndësisë ndërkombëtare.
- Konventa ndryshe njihet si Konventa e Ramsarit, në bazë të vendit Iranian ku edhe u miratua në shkurt të vitit 1971.
- Konventa sot është e ratifikuar nga 160 shtete dhe rrjeti i zonave Ramsar sot përbëhet prej 1911 zona ligatinore të rëndësisë ndërkombëtare me sipërfaqe prej 186 950 196 ha.

“Kënetat, moçalishte, toka torfike, sipërfaqe ujore, natyrore ose artificiale, me ujë të ëmbël, të njelmët ose të kripur, të përhershme apo të përkohshme, me ujë të fjetur ose të rrjedhshëm, duke përfshirë edhe ujërat detare thellësia e të cilave gjatë zbatimit nuk kalon 6 metrat |”

Konventa Ramsar (neni 1.1.)

- Viti 2011 është edhe përvjetori i dyzetë i kësaj konventës që përcakton kornizën për një bashkëpunim ndërkombëtar në mbrojtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të ligatinave.
- Tema ndërkombëtare për Ditën Botërore të Ligatinave 2011 është *"Ligatinat dhe pyjet - pyjet për ujë dhe ligatina"* me rastin e festimit të Vitit Ndërkombëtar të Pyjeve nga Kombet e Bashkuara.



MINISTRIA E MJEDISIT DHE
PLANIFIKIMIT HAPËSINOR



AGJENCIA PËR MBOJTJEN
E MJEDISIT TË KOSOVËS

2 SHKURTI, DITA NDËRKOMBËTARE E LIGATINAVE



VLERAT DHE FUNKSIONI I LIGATINAVE

RUAJTJA E LIGATINAVE NË KOSOVË

- Ligatinat janë një ndër mjediset më produktive në botë; quhen edhe “djep” i diversitetit biologjik, duke ofruar ujin dhe produktivitetin primar për ekzistencën e llojeve të panumërta të bimëve të gjitarëve, shpendëve, zvarranikëve, ujëtokësorëve, peshqve dhe llojeve jokurrizore.
- Ligatinat janë “magazina” të rëndësishme të materialit gjenetik bimorë. Orizi, p.sh. që është një bimë e zakonshme e ligatinave dhe ushqimi bazë për më tepër se gjysmën e njerëzimit.
- Ligatinat ofrojnë përfitime ekonomike mahnitëse, disa studime tregojnë se ekosistemet ofrojnë vlerën rreth 33 miliard US\$ në vit, prej të cilave 4.9 miliard US\$ nga ligatinat. Rreth 2/3 e gjuetisë botërore të peshkut është e lidhur me bregdetin dhe zonat e ligatinave,.

- Ligatinat kryejnë shumë funksione vitale, si p.sh.
 - deponim të ujit,
 - depozitim të shkarkimeve të shirave dhe rrjedhjeve ujore,
 - stabilizim të kushteve klimatike si reshjeve dhe temperaturës
 - moderues të përmbytjeve dhe shtrëngatave,
 - Kontrollues të erozionit, etj.



- Kosova është shtet i ri dhe ende nuk e ka të nënshkruar këtë konvente të rëndësishme ndërkombëtare.
- Edhe pse mungon një inventar i ligatinave, dihet se ekosistemet ujore në Kosovë janë mjaft të pasura.
- Një nga ligatinat më të rëndësishme tek ne është ajo e Hencit, e cila gjendet në afërsi të Aeroportit të Prishtinës, me sipërfaqe prej 70 ha.
- E formuar në mënyrë artificiale në vitet `60-ta me bashkim e rrjedhave të Magures dhe Vrelles, me synim kultivimin e krapit të zakonshme. Përveç llojeve tjera të florës dhe faunës së egër këtu jetojnë më shumë se 50 lloje të shpendëve.